



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 09.09.2014
Nr.0204-1242

PËR: Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr.06-4212/2014 të pranuar më datën 08.09.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr.06-4212/2014 të miratuar me datën 29.08.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, 01.Nr.463-3535/2014, i datës 09.07.2014 që ka të bëjë me dhënien e miratimit paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së rregullt të ankandit publik.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 09.09.2014

Br.0204-1242

za: Sokol Bashota, Gradonačelnik Opštine Klina
Haxhi Ibishi, Predsedavajući Skupštine Opštine Klina

PREDMET : POTVRDAZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE KLINA br.06-4212/2014 primljenog dana 08.09.2014

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ,bazirajući se na ovlašćenja i odgovornosti određenim članom br. 81.4 zakona za lokalno samoupravljanje ,kao i pravilnikom br. 02/2011, za polja i odgovornosti administrativne Kancelarije Premijera i Ministarstva,prilog XII posle rasprave odluke br. **06-4212/2014 usvojene dana 29.08.2014** od strane skupštine opštine Klina , POTVRDJUJE zakonitost akta ,i ocenjuje da je isti u skladu sa zakonom za lokalno samoupravljanje.

Pravni akt koji proizvodi potpuni pravni efekat je kao u nastavku:

- Odluka za usvajanje predloga Gradonačelnika Opštine, 01.br.463-3535/2014, dana 09.07.2014 u vezi sa prethodnim odobrenjem odluke za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine ,preko redovne procedure jave licitacije .
respekt,

S' poštovanjem

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopja: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodećima u departamentima u MALS-u
Arhivi MALS-a



KOMUNA E KLINËS

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-411/2014

Klinë, dt.29.08/2014

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 3, të Ligjit nr. 04/L - 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, 01. nr.110-1232/2010, të dt. 07.04.2010, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e mbajtur, me datën 29.08.2014, miratohet këtë:

VENDIM

I. **MIRATOHET**, Propozimi i Kryetarit të Komunës, 01.Nr.463-3535/2014, i datës 09.07.2014 që ka të bëjë me dhënien e miratimit paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së rregullt të ankandit publik.

II. **MIRATOHET**, vendimi paraprak për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunes së Klinës në shfrytëzim afatshkurter, sipas propozimit të kryetarit si nga pika I e këtij vendimi dhe kriterëve të percaktuara si në piken III të këtij vendimi.

III. Sipas pikes I dhe II të këtij vendimi, pronat e paluajtshme të Komunës së Klinës të cilat do të jepen në shfrytëzim afatshkurter për 10 vite, janë si në vijim:

1. Pjesa e parceles kadastrale nr.567/2 në sip. prej 200 m² (0.02,00 ha), e cila gjendet në ZK Videjë Komuna e Klinës, e cila evidentohet si pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Klinë, sipërfaqja e përgjithshme e se cilës është 0.29,15 ha.
2. Pjesa e parceles kadastrale nr.327/6 në sip. prej 169 m² (0.01,69 ha), e cila gjendet në ZK Klinavc Komuna e Klinës, e cila evidentohet si pronë shoqërore Kuvendi Komunal Klinë, sipërfaqja e përgjithshme e se cilës është 0.52,00 ha.
3. Pjesa e parceles kadastrale nr.324/0 në sip. prej 211 m² (0.02,11 ha), e cila gjendet në ZK Ujmirë Komuna e Klinës, e cila evidentohet si pronë shoqërore Kuvendi Komunal Klinë, sipërfaqja e përgjithshme e se cilës është 0.96,43 ha.

IV. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi është ofrimi i ndihmes dhe perkrahja e ekonomive familjare të komunitetit të vendit dhe rrethines ku gjenden pronat si në piken III të këtij vendimi, ngase në rastin si nga pika 1 në ZK Videjë do të ndërtohet therrtorja perkatese për nevoja të komunitetit nga perfituesi i ankandit, perderisa në rastin si nga pika 2 dhe 3 të këtij vendimi në ZK Klinavc dhe ZK Ujmirë do të bëhet funksionalizimi i objekteve egzistuese të qumeshoreve perkatese të cilat do të jenë në interes të komunitetit.

V. Afati kohor për dhënien e pronave të cekur si në pikën III të këtij vendimi është afatëshkurtër në periudhën prej dhjetë (10) vite.

VI. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatëshkurtër realizohet përmes ankandit publik.

VII. Komisioni për vlerësimin e ofertave bënë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e ankandit publik sipas Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nr.04/L-144, Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Ligjit të Prokurimit Publik, i cili komisioni përgatit kushtet për mbajtjen e ankandit dhe i përcakton kriteret në njoftim duke përfshirë çmimin fillestar, afatin e dhënies në shfrytëzim, lokacionin si dhe kriteret tjera të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.

VIII. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhën afatshkurter.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, Kryetari i Komunës, organi kompetentë për pronë dhe organi kompetentë për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

X. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës dhe konfirmimit të ligjshmerisë së tij nga ana e MAPL-së.

Të njoftohen:

- Kryetari i Komunës;
- Komisioni;
- MAPL-ja;
- Zyra Komunale e Prokurimit Publik;
- Zyra e Informimit si dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

